



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA “ALBPETROL” SHA

Nr. _____ Prot.

Patos, më _____. _____. 2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Data 30.08.2024

Nga: “Albpetrol” sha – Patos

Drejtuar: OE, “VESA 2014” shpk me NUIS L42612401O me adresë: Lagjja “16 Prilli”, Rruga “Llukan Toska”, afër Stadiumit, Fier.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-11854-07-02-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje pajisje mbrojtëse individuale për punonjësit dhe veshmbathje”

Kohëzgjatja e kontratës është 30 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 35 datë 8 Korrik 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë Procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “GENTIAN SADIKU” pf me NUIS L42314005A me vlerë oferte në total 18,280,500 lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik “MALBERTEX” shpk me NUIS K71821009N me vlerë oferte në total 17,252,420 lekë pa TVSH.
3. Operatori ekonomik “MUCA” shpk me NUIS K01421002H nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
4. Operatori ekonomik “VESA 2014” shpk me NUIS L42612401O me vlerë oferte në total 18,063,400 lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- Operatori ekonomik “GENTIAN SADIKU” pf me NUIS L42314005A për arsyet e mëposhtme:

- *Operatori ekonomik nuk ka paraqitur perpara afatit të fundit për hapjen e ofertave, nga një mostër përfaqësuese copë/palë për të gjithë artikujt, sipas tabelës së sasive.*
 - *Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*
 - *Operatori ekonomik nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori te autorizuar per artikujt objekt prokurimi te kerkuar.*
 - *Operatori ekonomik nuk ka paraqitur katalog/skede teknike nga prodhuesi, per artikujt objekt i prokurimit.*
 - *Operatori ekonomik nuk ka paraqitur certifikatat e konformitetit per secilin nga artikujt e ofruar sipas certifikimeve/standarteve të kërkuara në shtojcën 5 “Specifikimet teknike”, ose ekuivalente me to.*
- Operatori ekonomik “MALBERTEX” shpk me NUIS K71821009N për arsyet e mëposhtme:
 - *Operatori ekonomik nuk ka paraqitur perpara afatit të fundit për hapjen e ofertave, nga një mostër përfaqësuese copë/palë për të gjithë artikujt, sipas tabelës së sasive.*
 - *Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.*
 - *Operatori ekonomik nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori te autorizuar per artikujt objekt prokurimi te kerkuar.*
 - *Operatori ekonomik nuk ka paraqitur katalog/skede teknike nga prodhuesi, per artikujt objekt i prokurimit.*
 - *Operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023.*
 - *Operatori ekonomik nuk ka paraqitur certifikatat e konformitetit per secilin nga artikujt e ofruar sipas certifikimeve/standarteve të kërkuara në shtojcën 5 “Specifikimet teknike”, ose ekuivalente me to.*
- Operatori ekonomik “MUCA” shpk me NUIS K01421002H për arsyet e mëposhtme:
 - *Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument.*
 - *Operatori ekonomik nuk ka paraqitur perpara afatit të fundit për hapjen e ofertave, nga një mostër përfaqësuese copë/palë për të gjithë artikujt, sipas tabelës së sasive.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE, “VESA 2014” shpk, adresa: Lagjja “16 Prilli”, Rruga “Llukan Toska”, afer Stadiumit, Fier, me NUIS L42612401O, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 18,063,400 (tetëmbëdhjetë milion e gjashtëdhjetë e tre mijë e katërqind) leke pa TVSH, është identifikuar si Ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimit Publik të “Albpetrol” sha, rruga Fier – Patos km 7, Fier, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, dhe tenderi do të anulohet, siç parashikohet në nenet 83 dhe 98 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Eltar DEDA